

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Gjykata Supreme e Kosovës
AP.-KŽ. Nr. 62/2012
Prishtinë
08 maj 2012

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës ka mbajtur seancë në përputhje me nenin 26 paragrafin (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), në nenin 15.4 të Ligjit mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Çaktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (LmK) më 27 mars 2012 në Gjykatën Supreme në kolegjin e përbërë prej gjyqtarit të EULEX-it Gerrit-Marc Sprenger si kryetar të kolegjit, gjyqtares së EULEX-it Anne Kerber dhe gjyqtares së Gjykatës Supreme të Kosovës Marije Ademi si anëtarë të kolegjit, dhe zyrtarit ligjor Holger Engelmann si procesmbajtës,

Në praninë e

Avokatit mbrojtës Xh [redacted] Sh [redacted] për të pandehurin Xh [redacted] ZH [redacted],
Avokatit mbrojtës A [redacted] K [redacted] për të pandehurin B [redacted] H [redacted],
Avokatit mbrojtës A [redacted] V [redacted] për të pandehurin N [redacted] C [redacted],
Avokatit mbrojtës A [redacted] A [redacted] për të pandehurin A [redacted] K [redacted],

dhe të pandehurve Xh [redacted] ZH [redacted] dhe N [redacted] C [redacted]

Në lëndën penale me numër AP.-KŽ. Nr. 62/2012 kundër të pandehurve:

Xh [redacted] ZH [redacted]

A [redacted] K [redacted]

[REDACTED]

B [REDACTED] H [REDACTED]

[REDACTED]

[REDACTED]

[REDACTED]

[REDACTED]

N [REDACTED] C [REDACTED]

[REDACTED]

[REDACTED]

Në përputhje me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë si gjykatë e shkallës së parë në lëndën nr. P. Nr. 57/10, të datës 21 prill 2011 të regjistruar në Shkrimoren e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë në të njëjtën ditë, të pandehurit janë shpallur fajtorë për veprat penale në vijim:

Të pandehurit Xh [REDACTED] ZH [REDACTED] A [REDACTED] K [REDACTED] B [REDACTED] H [REDACTED] dhe N [REDACTED] C [REDACTED]:

Për kryerje të veprës penale të detyrimit, në kundërshtim me nenin 267 paragrafët 1 dhe 2 të Kodit Penal të Kosovës (KPK) lidhur me nenin 23 të KPK-së, sepse duke vepruar në bashkëkryerje si pjesë e grupit në disa data të ndryshme në mes, më ose rreth datës 26 qershor 2006 dhe 01 gusht 2006, me qëllim të përfitimit material të paligjshëm për vetveten apo të tjerët, ushtroi kërcënime serioze për ta shtyrë tjetrin të bëjë apo ose të përmbahet nga bërja e një veprimi në dëm të pronës së tij; veçanërisht të pandehurit kërcënuan se do t'i vrisnin palët e dëmtuara nëse nuk tërhiqen nga tenderi tyre fitues i AKM-së (Vala e 16-të) për fermën 32 hektarësh në fshatin R [REDACTED] Komuna e F [REDACTED] Gjatë disa ditëve prej, më ose rreth datës 27 korrik 2006 deri 01 gusht 2006 të pandehurit detyruan palët fituese të tërhiqen nga tenderi me anë të kërcënimeve të drejtpërdrejta ose indirekte për vrasje. Si pasojë e këtyre kërcënimeve viktimat Sh [REDACTED] L [REDACTED] Xh [REDACTED] S [REDACTED] dhe A [REDACTED] S [REDACTED] u pajtuan të tërhiqen nga tenderi dhe me këtë ata e dorëzuan interesin e tij te A [REDACTED] K [REDACTED] tenderuesi i dytë për nga lartësia. Më ose rreth datës 08 gusht 2006, B [REDACTED] H [REDACTED] dhe N [REDACTED] C [REDACTED] e shoqëruan Sh [REDACTED] L [REDACTED] deri te zyrat e AKM-së në Prishtinë kur pala e dëmtuar faktikisht paraqiti tërheqjen nga tenderi, duke ju dhuruar në këtë mënyrë të pandehurve përfitim të madh material;

Vetëm i pandehuri Xh [REDACTED] ZH [REDACTED]

Për kryerje të veprës penale të mbajtjes ë pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në kundërshtim me nenin 328 paragrafin 2 të KPK-së, sepse më 04 nëntor 2008, gjatë bastisjes së shtëpisë së Xh [REDACTED] XH [REDACTED] në K [REDACTED], policia gjeti se ai ishte në posedim të një sasie të armëve të zjarrit, municionit dhe eksplozivëve pa leje të vlefshme për armëmbajtje apo ndonjë formë tjetër të licencës. Xh [REDACTED] ZH [REDACTED] kishte armë automatike "MPT-9" të kalibrit 9x19 mm, numri serik i armës është i shkruar në alfabetin persisht të deshifruar si 73-23328, armë automatike "MPT-9" të kalibrit 9x19 mm, numri serik i armës është i shkruar në alfabetin persisht të deshifruar si 732322, armë automatike "AK-47" të kalibrit 7.62x39 mm me numër serik E-75572, pistoletë "Crvena Zastava" modeli 99, të kalibrit 9x19 mm me numër serik 72915, gjashtë karikatorë, një shumicë fishekësh, një mjet të pashpërthyer "Mortar 88 mm" dhe një shumicë eksplozivash;

Vetëm i pandehuri A [REDACTED] K [REDACTED]:

Për kryerje të veprës penale të mbajtjes ë pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në kundërshtim me nenin 328 paragrafin 2 të KPK-së, sepse më 04 nëntor 2008, gjatë ekzekutimit të urdhrin për bastisje në shtëpinë e A [REDACTED] K [REDACTED], policia gjeti se A [REDACTED] K [REDACTED] ai ishte në posedim të një pistolette "Ekol Special" modeli 99, me numër serik V760928, e cila pistoletë ishte rimodeluar në punëdore dhe ishte shndërruar në armë zjarri të kalibrit 7.65x17 mm.

Prandaj, të pandehurit u shpallën fajtorë si në vijim:

A [REDACTED] K [REDACTED] u dënua me tri vjet burgim për Pikën 1 të aktakuzës dhe me gjobë prej 1,500 Eurosh për posedim të paligjshëm të armëve. Koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak u vendos të përfshihet në vuajtjen e dënimit kur aktgjykimi të bëhet i formës së prerë;

Xh [REDACTED] XH [REDACTED] u dënua me tri vjet burgim për Pikën 1 të aktakuzës dhe me gjobë prej 1,500 Eurosh për posedim të paligjshëm të armëve.

B [REDACTED] H [REDACTED] u dënua me një vit e dy muaj burgim;

N [REDACTED] C [REDACTED] u dënua me një vit e dy muaj burgim.

Gjykata e shkallës së parë vendosi që të pandehurit duhet të paguajnë gjobën brenda tre muajve pasi aktgjykimi të bëhet i formës së prerë. Në rast se gjoba nuk mund të mblidhet me detyrim, pagesa e gjobës do të zëvendësohet me një ditë burg për çdo pesëmbëdhjetë euro të gjobës.

Të pandehurit Xh. [REDAKTUAR] ZH. [REDAKTUAR], A. [REDAKTUAR] K. [REDAKTUAR], B. [REDAKTUAR] H. [REDAKTUAR] dhe N. [REDAKTUAR] C. [REDAKTUAR] u shpallën të pafajshëm për kryerjen e veprës penale të Kanosjes në kundërshtim të nenit 161 paragrafit 4 të KPK-së.

Avokatët mbrojtës të pandehurve kanë ushtruar me kohë ankesat e tyre kundër aktgjyqimit. Avokati mbrojtës A. [REDAKTUAR] V. [REDAKTUAR] ushtroi ankesën e tij në emër të pandehurit N. [REDAKTUAR] C. [REDAKTUAR] më 07 tetor 2011, avokati mbrojtës A. [REDAKTUAR] K. [REDAKTUAR] ushtroi ankesën e tij në emër të pandehurit B. [REDAKTUAR] H. [REDAKTUAR] më 14 gusht 2011, kurse avokati mbrojtës A. [REDAKTUAR] A. [REDAKTUAR] ushtroi ankesën e tij në emër të të pandehurit A. [REDAKTUAR] K. [REDAKTUAR] më 26 shtator 2011 dhe avokati mbrojtës Xh. [REDAKTUAR] Sh. [REDAKTUAR] ushtroi ankesën e tij në emër të pandehurit Xh. [REDAKTUAR] ZH. [REDAKTUAR] më 07 tetor 2011. Të gjitha ankesat kanë pohuar se aktgjykimi përmban shkelje esenciale të procedurës penale, se gjendja faktike është vërtetuar gabimisht dhe jo plotësisht, se përmban shkelje esenciale të kodit penal dhe dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarve do të kundërshtohet. Avokati mbrojtës i të pandehurit Xh. [REDAKTUAR] ZH. [REDAKTUAR] ka propozuar të anulohet aktgjykimi i kundërshtuar dhe lënda të kthehet për rigjykim në gjykatë të shkallës së parë ose të lirohet i mbrojturi i tij nga të gjitha akuzat, avokati mbrojtës i B. [REDAKTUAR] H. [REDAKTUAR] ka propozuar të anulohet aktgjykimi i kundërshtuar dhe lënda të kthehet për rigjykim në gjykatë të shkallës së parë ose të shqiptohet një dënim më i butë kundër të mbrojturit të tij, avokati mbrojtës i N. [REDAKTUAR] C. [REDAKTUAR] ka propozuar të lirohet i mbrojturi i tij nga të gjitha akuzat dhe avokati mbrojtës i A. [REDAKTUAR] K. [REDAKTUAR] ka propozuar të anulohet aktgjykimi i kundërshtuar dhe lënda të kthehet për rigjykim në gjykatë të shkallës së parë ose të lirohet i mbrojturi i tij nga pika 1 e aktakuzës dhe të zvogëlohet dënimi për pikën 4 të aktakuzës.

Prokurori Special i Kosovës (PRSK) nuk ka ushtruar ankesë kundër aktgjyqimit të Gjykatës së Qarkut.

Zyra e Prokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPSHK), me mendimin e datës 23 mars 2012 propozoi të pranohet pjesërisht ankesa e ushtruar nga avokati mbrojtës Xh. [REDAKTUAR] Sh. [REDAKTUAR] në emër të pandehurit Xh. [REDAKTUAR] ZH. [REDAKTUAR] sa i përket pjesës dënuese të aktgjyqimit dhe koha që Xh. [REDAKTUAR] ZH. [REDAKTUAR] ka kaluar në paraburgim llogaritet në dënimin ndaj të pandehurit; por propozoi të gjitha arsyet e tjera të ankesës të refuzohen si të pabazuara dhe të vërtetohet aktgjykimi i shkallës së parë.

Seanca me ankesë filloi më 08 maj 2012 në praninë e të pandehurve Xh. [REDAKTUAR] Zh. [REDAKTUAR] dhe N. [REDAKTUAR] C. [REDAKTUAR] dhe të gjithë avokatëve mbrojtës të lartpërmendur. Të gjitha palët janë njoftuar me kohë për seancën ankimore. Avokatët mbrojtës në fjalimet e tyre përfundimtare dhe të pandehurit gjatë fjalës së tyre përfundimtare plotësisht iu referuan propozimeve të paraqitura më parë në ankesat me shkrim.

Duke u bazuar në aktgjykimin me shkrim në lëndën P, Nr. 57/10 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë të datës 21 prill 2011 (të paraqitur në shkrimoren e kësaj gjykate në të njëjtën ditë), ankesat me shkrim të pandehurit, dosjet përkatëse dhe parashtresat verbale të palëve gjatë seancës dëgjimore, bashkë me analizën e ligjit në fuqi, Gjykata Supreme e Kosovës, pas këshillimeve të mbajtura më 08 maj 2012, lëshon këtë:

AKTGJYKIM

(1) Ankesa e avokatit mbrojtës e ushtruar në emër të të pandehurit Xh [REDACTED] ZH [REDACTED] kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P. Nr. 57/2010, të datës 21 prill 2011, PRANOHET PJESËRISHT. Aktgjykimi i shkallës së parë ndryshohet si në vijim: Koha që i pandehuri Xh [REDACTED] ZH [REDACTED] ka kaluar në paraburgim llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim. Për pjesën tjetër ankesa REFUZOHET SI E PABAZUAR.

(2) Ankesat e avokatëve mbrojtës të ushtruara në emër të të pandehurve A [REDACTED] K [REDACTED], B [REDACTED] H [REDACTED] dhe N [REDACTED] C [REDACTED] kundër aktgjykimit të përmendur REFUZOHEN SI TË PABAZUARA.

(3) Dispozitivi i aktgjykimit ndryshohet EX-OFFICIO si në vijim:

I pandehuri A [REDACTED] K [REDACTED] kishte në posedim pistoletën “Ekol Special” modeli 99, me numër serik V760928, e cila ishte rimodeluar dhe shndërruar në armë zjarri të kalibrit 7.65x17mm pa leje të duhur për armëmbajtje apo çfarëdo forme të licencës.

Armët dhe municioni i paautorizuar i konfiskuar në shtëpinë e të pandehurit Xh [REDACTED] ZH [REDACTED], përkatësisht: dy armë automatike MPT-9 të kalibrit 9x19 mm, numri serik i armës është i shkruar në alfabetin persisht 73-23328 dhe 732322, një armë automatike AK-47 e kalibrit 7.62x39 mm me numër serik E-75572, një pistoletë “Crvena Zastava” modeli 99, e kalibrit 9x19 mm me numër serik 72915, si dhe gjashtë karikatorë, një shumicë fishekësh, një shumicë eksplozivash dhe një mjet të pashpërthyer “Mortar 88 mm” dhe

armët dhe municioni i paautorizuar i konfiskuar në shtëpinë e të pandehurit A [REDACTED] K [REDACTED], përkatësisht: 3 granata dore, një pushkë automatike AK-47 e kalibrit 7.62x39mm, me numër serik 0120114-91, një pistoletë “Ekol Special” modeli 99, me numër serik V760928, e cila ishte rimodeluar dhe shndërruar në armë zjarri të kalibrit 7.65x17mm dhe një shumicë e municionit janë konfiskuar.

(4) Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut VËRTETOHET NË PJESËT E MBETURA.

ARSYETIM

Historia e procedurës

Më 01 mars 2010, Prokurori Special i Kosovës (PSRK) ka paraqitur aktakuzë kundër Xh. ZH., A. K., B. H., N. C. F. H. N. C. dhe A. D. duke i akuzuar të pandehurit për Detyrim, Kanosje dhe të pandehurit Xh. ZH. dhe A. K. gjithashtu edhe për Posedim të kundërligjshëm të armëve. Aktakuza pretendon se të pandehurit duke vepruar në bashkëkryerje si pjesë e një grupi kriminal, në data të ndryshme në mes 26 korrikut 2006 dhe 1 gushtit 2006 kanë kryer veprën penale Detyrim duke përdorur kërcënime kundër Sh. L. Xh. S. dhe A. S. në mënyrë që të përfitojnë materialisht nga këto aktivitete. Kështu, rreth 27 korrikut 2006, ata kanë kërcënuar me vrasje palët e dëmtuara nëse nuk do të tërhiqeshin nga fitorja e tyre e tenderit të AKM-së (vala e 16-të) për 32 hektarë të një ferme të deleve në R. Komuna e F. Të pandehurit pretendohet se më tutje kanë kërcënuar viktimat rreth 28 korrikut 2006, duke iu thënë atyre se nëse nuk tërhiqen do të ketë gjakderdhje. Në të njëjtën ditë, 28 korrik 2006, Xh. ZH. ka thirrur Xh. S. dhe e ka kërcënuar atë, më vonë ka ndodhur një takim në shtëpinë e Xh. S. të cilin ka marrë pjesë N. C. ku viktimave ju është thënë përsëri që të tërhiqen. Rreth 29 korrikut 2006, viktimave ju është thënë nga N. C. që të tërhiqen ose do të ketë gjakderdhje. Në një takim në Sh., në një datë në mes 30 korrikut dhe 3 gushtit 2006, si rezultat i këtyre kërcënimeve viktimat Sh. L., Xh. S. dhe A. S. janë pajtuar që të tërhiqen nga tenderi dhe i kanë dorëzuar interesat e tyre A. K., ofertuesi i dytë më i lartë.

Më tutje, aktakuza ngarkon A. K. dhe Xh. ZH. për Posedim të kundërligjshëm të armëve, sepse gjatë bastisjeve të kryera në shtëpinë e Xh. ZH. policia ka gjetur dhe ka konfiskuar armën automatike "MPT-9" të kalibrit 9x19 mm, me numër serik të shkruar në alfabetin Persian të deshifruar si 73-23328, armën automatike "MPT-9" të kalibrit 9x19 mm, me numër serik të shkruar në alfabetin Persian të deshifruar si 732322, pushkën automatike "AK-47" të kalibrit 7.62x39 mm me numër serik E-75572, pistoletën "Crvena Zastava" modeli 99, të kalibrit 9x19 mm me numër serik 72915, gjashtë karikatorë, sasi të plumbave, një mjet eksploziv të pashpërthyer "Mortajë 88 mm" dhe një sasi të eksplozivëve. Njësoj, policia ka bastisur shtëpinë e A. K. dhe ka gjetur një sasi të armëve të zjarrit, municion dhe eksploziv pa leje të vlefshme për armëmbajtje ose ndonjë formë të licencimit të duhur. Respektivisht, ata kanë gjetur dhe kanë konfiskuar një pistoletë "Ekol Special" modeli 99, me numër serik V760928, pistoletë e cila është ri-dizajnuar në mënyrë manuale dhe është konvertuar në armë zjarri të kalibrit 7.65x17 mm, tri granata të dorës dhe një pushkë automatike AK-47 të kalibrit 7.62x39 mm, me numër serik 0120114-91.

Seanca për konfirmim është mbajtur më 07 korrik 2010, para gjyqtarit për konfirmim të EULEX-it, në kuadër të cilit Prokurori i PSRK-së ka ndryshuar pikën e parë të aktakuzës fillestare, në mënyrë që të shkruhet se të pandehurit kanë qenë pjesë "e një grupi kriminal", në vend të "pjesë e një grupi kriminal" siç është përmendur fillimisht në aktakuzë.

Më 19 korrik 2010, gjyqtari për konfirmim ka konfirmuar aktakuzën në tërësi.

Shqyrtimi gjyqësor ka filluar përmes 15 seancave më 17 dhe 18 nëntor, 06 dhe 08 dhjetor 2010, 14, 15, 16, 18, 21, 22, 23, 24 shkurt, 13, 14 dhe 15 mars dhe më 21 prill 2011, ku në të fundit publikisht është shpallur aktgjykimi i kundërshtuar.

Dëshmitarët në vijim janë paraqitur dhe kanë dëshmuar në gjykim: Xh. S., Sh. L., A. S., E. S., S. Z., D. V., R. R., L. dhe G. S.. Vetë të pandehurit kanë vendosur të mbrohen duke dëshmuar, prandaj dëshmia e tyre është dëgjuar nga trupi gjykues.

Përveç dëshmive të dëshmitarëve, trupi gjykues ka pranuar provat në vijim: shënimet hetimore të S. T. të datës 10 prill 2008, në lidhje me numrat e telefonit të E. S. i cili i ka pasur në kohën përkatëse; shënimet hetimore të S. T. të datës 09 prill 2008, duke e njoftuar se PTK-ja nuk ka fare ndonjë informacion lidhur me regjistrin e thirrjeve për periudhën korrik 2006 – gusht 2006; shënimet hetimore të S. T. të datës 03 prill 2008 në lidhje me takimin e Xh. S. në mënyrë që marrë informacione shtesë lidhur me numrat e telefonave, gjithashtu kërkesa nga dëshmitari që të sigurojë listën e kërcënimeve; shënimet hetimore të S. T. të datës 04 prill 2008 në lidhje me takimin me Xh. S. i cili ka sjellë listën e kërcënimeve të cilat i ka pranuar përmes telefonit mobil me numër , dhe në numrin e telefonit të djalit të tij , SMS mesazhet të cilat i ka pranuar në numrin e telefonit , detajet e thirrjeve kërcënuese të pranuar nga djali i Xh. S. D. S. shënimet hetimore të S. S. të datës 24 mars 2008, duke njoftuar se Agjencia Kosovare i Mirëbesimit (AKM-ja) i kishte shkatërruar të gjitha regjistrat e hyrjes së vizitorëve për vitin 2006; shkresën e AKM-së të datës 20 mars 2008, duke njoftuar se depozitimit i është kthyer dëshmitarit Sh. L. CBAK transferimi i parave prej 50.000 Euro nga AKM-ja në I. kthimi i depozitimit; shënimet hetimore të S. S. intervista me Sh. B. duke njoftuar se AKM-ja kishte shkatërruar regjistrin e hyrjes së vizitorëve për vitin 2006; shënimet hetimore të S. S. të datës 15 mars 2008; shkresa tek AKM-ja nga S. S. e datës 13 mars 2008; shënimet hetimore të S. S. të datës 12 mars 2008; shënimet e ditarit të Sh. L. duke i listuar kërcënimet; shënimet hetimore të S. S. të datës 12 mars 2008; kërcënimet e mëtutjeshme të listuara nga Sh. L. shënimet hetimore të S. S. të datës 10 March 2008; detajet e veprimeve hetimore; raporti i policisë nga Th. Ch. i datës 10 mars 2008; shënimet hetimore të S. S. të datës 06 mars 2008; foto identifikimi nga A. S. dhe fotografitë; shënimet hetimore të S. S. të datës 06 mars 2008; foto identifikimi nga Xh. S. dhe fotografitë; raporti i policisë nga Th. Ch. i datës 05 mars 2008; shqyrtimi i dokumenteve të AKM-së; raporti i policisë nga Th. Ch. i datës 05 mars 2008; rreshtimi i fotografive Sh. L. raporti i policisë nga Th. Ch. i datës 01 mars 2008; raporti i policisë nga Th. Ch. i datës 19 shkurt 2008; raporti i policisë nga V. M. i datës 15 shkurt 2008; raporti i policisë nga S. S. i datës 15 shkurt 2008; raporti i policisë nga Th. Ch. i datës 14 shkurt 2008;

shënimet e bastisjes në lidhje me shtëpinë e A. K., shënimet e bastisjes në lidhje me shtëpinë e Xh. ZH., raporti i policisë nga Rreshteri A. R. i datës 04 nëntor 2008 lidhur me arrestimin dhe bastisjen e A. K., shënimet hetimore të S. T. të datës 20 tetor 2008; raporti i njësisë së largimit të mjeteve shpërthyes SFC Chebahtah P99, numri i incidentit 753-116-07, lidhur me largimin e mjetit të gjetur nga Sh. L. në shtëpinë e tij më 02 tetor 2007 dhe i identifikuar si "Mortajë Jugosllave M57 60mm"; memorandum i Rreshterit D. V. i datës 04 nëntor 2008, shënimet nga ditari i Sh. L. (pa datë); raporti nga S. T. i datës 04 gusht 2008; kërkesa në PTK për regjistrin e telefonave të datës 23 maj 2008; raporti nga S. T. i datës 23 maj 2008; regjistri i thirrjeve telefonike dhe SMS mesazheve; raporti nga S. T. i datës 29 prill 2008 lidhur me ofertën e mundshme nga G. S. shitja e marrëveshjes së pronës së Xh. S. i datës 14 qershor; raporti i policisë H. B. i datës 08 prill 2009, detajet e aktiviteteve të policisë në marrjen e një raporti nga KFOR-i lidhur me eksplozivët e gjetur gjatë bastisjes; M. G., inventari i artikujve të konfiskuar, të cilat i janë dorëzuar EULEX-it; raporti i policisë nga J. K. i datës 16 shkurt 2009; raporti i policisë nga J. K. i datës 10 mars 2009; marrëveshja e qiramarrjes për fermën e deleve në mes të B. M. dhe M. R. dhe B. A. për A. K. e datës 14 gusht 2008; ekzaminimi balistik; raporti i policisë nga J. K. i datës 20 janar 2009; CD-ja e incizuar në takimin e S. dhe e dorëzuar nga Xh. ZH. te S. D., vëllai i A. D., përmbledhja e CD-së; raporti i policisë nga S. S. i datës 10 mars 2008; raporti i policisë nga S. S. i datës 10 mars 2008, mbi marrjen e numrave të telefonit nga viktimat Xh. S. lidhur me kërcënimet; raporti mbi bastisjen e shtëpisë nga Rreshteri D. V. lidhur me Xh. ZH. i datës 04 nëntor 2008; raporti i policisë nga A. F. i datës 04 nëntor 2008; raporti i policisë nga V. M. i datës 15 shkurt 2008; raporti i policisë nga S. S. i datës 12 nëntor 2008 mbi konfiskimin e laptopit HP S/N CNF7050PDF nga Xh. ZH., raporti i policisë nga A. F. i datës 07 nëntor 2008 lidhur me kontaktet me Xh. ZH. pas arrestimit të pandehurve; shënimet e bastisjes B. H., shënimet e bastisjes Xh. ZH., raporti i policisë nga S. K. lidhur me bastisjen e B. H.; shënimet e bastisjes dhe arrestimit lidhur me N. O. shënimet e bastisjes dhe arrestimit lidhur me A. K.

Gjatë seancave të shqyrtimi gjyqësor më 18 shkurt 2011, Prokurori Publik ka tërhequr aktakuzën kundër F. H. dhe A. D. dhe gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor më 24 shkurt 2011, Prokurori Publik ka tërhequr akuzat kundër të pandehurit N. C.

Në bazë të gjetjeve të saj më 30 mars 2009 Gjykata e Qarkut ka shpallur aktgjykimin dhe ka shpallur të pandehurit fajtorë për veprat penale të lartpërmendura. Si rrjedhojë, gjykata i ka shqiptuar të pandehurve dënimet siç janë specifikuar më lart.

Avokatët mbrojtës të pandehurve kanë paraqitur ankesat me kohë kundër aktgjykimin siç është cekur më lartë dhe kanë pretenduar se aktgjykimin përmban shkelje esenciale të

procedurës penale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkelje të kodit penal dhe kundërshtojnë dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarve. Është propozuar që aktgjykimi i kundërshtuar ose të anulohet dhe të kthehet lënda në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë ose të lirohet i pandehuri Xh. ZH. nga të gjitha akuzat, ose të anulohet aktgjykimi i kundërshtuar dhe lënda të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë ose të shqiptohet një dënim më i butë kundër të pandehurit B. H. të lirohet i pandehuri N. C. nga të gjitha akuzat dhe të anulohet aktgjykimi i kundërshtuar dhe lënda të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë ose të lirohet i pandehuri A. K. nga akuzat nën pikën 1 të aktakuzës dhe t'i zvogëlohet dënimi lidhur me pikën 4 të aktakuzës.

PSRK-ja nuk ka paraqitur ankesë kundër aktgjyqimit të shkallës së parë.

ZPSH-ja në mendimin e saj ka propozuar siç është cekur më lartë.

GJETJET E GJYKATËS

A. Shkelja substanciale e dispozitave të procedurës penale

Të katër avokatët mbrojtës kanë kundërshtuar aktgjykimin e shkallës së parë për shkelje substanciale të procedurës penale, pasi që aktgjykimi është kundërtëhënës në përmbajtjen e tij; në veçanti dispozitivi është në kundërtënie me arsyetimin. Mbrojtja e X. ZH. ka theksuar se vepra penale Detyrim sipas nenit 267 paragrafëve 1 dhe 2 të KPK-së siç i janë referuar në aktgjykimin e kundërshtuar nuk mund të qëndroj në lëndën në fjalë për faktin se i pandehuri është shpallur i pafajshëm për veprën penale Kanosje sipas nenit 161 të KPK-së dhe se nuk është paraqitur asnjë provë për përdorimin e forcës. Për më tepër, koha e të pandehurit e kaluar në paraburgim nuk është përfshirë në dënim, që është shkelje e nenit 391 paragrafit 1 pikës 5 të KPPK-së dhe atëherë do të kishim të bënim me nenin 403 paragrafit 2 të KPPK-së. Mbrojtja e B. H. ka pohuar se – edhe pse B. H. N. C. A. K. dhe Xh. ZH. janë shpallur fajtorë për Detyrim në bashkëkryerje dhe për veprim si pjesë e një grupi – aktgjyqimit i mungon përshkrimi i qartë i veprimeve aktuale inkriminuese të veprës penale dhe nuk e merr parasysh në mënyrë të mjaftueshme faktin se asnjëri prej dëshmitarëve asnjëherë nuk ka cekur se B. H. kishte kërcënuar ndonjëherë dikë. Avokati mbrojtës i N. C. ka theksuar se klienti i tij trajtohet vetëm si “pjesëtar i një grupi” dhe bart peshën e njëjtë të fajësisë, përderisa në të vërtetë asnjëherë nuk është provuar se ai ka kërcënuar ndonjëherë palët e dëmtuara. E fundit por jo më pak e rëndësishme, avokati mbrojtës i A. K. pretendon se dispozitivi i aktgjyqimit të shkallës së parë është i paqartë dhe në kundërshtim me arsyetimin nën pikën (I), pasi që klienti i tij vazhdimisht e ka mohuar kryerjen e veprës penale përkatëse dhe prandaj aktgjykimi nuk është i bazuar në fakte relevante.

I. KANOSJA SIPAS NENIT 161 I KPK-SË SI PARAKUSHT I
PRETENDUAR PËR DETYRIM SIPAS NENIT 267 TË KPK-SË:

Lidhur me argumentimin përkatës të mbrojtjes së Xh [REDACTED] ZH [REDACTED] Gjykata Supreme e Kosovës gjen se në të vërtetë dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar tregon disa kundërthënie në lidhje me shpalljen fajtorë të të pandehurve Xh [REDACTED] ZH [REDACTED] A [REDACTED] K [REDACTED], B [REDACTED] H [REDACTED] dhe N [REDACTED] C [REDACTED] për Detyrim në kundërshtim të nenit 267 paragrafëve 1 dhe 2 të KPK-së dhe shpalljen të pafajshëm të të katërve për veprën penale Kanosje në kundërshtim të nenit 161 të KPK-së. Megjithatë, këto kontradikta mbështeten vetëm në formulimin e ngathtë të dispozitivit, kur kemi të bëjmë me shpalljen e të pandehurve të pafajshëm për veprën penale të kanosjes. Për më tepër, edhe nëse kemi të bëjmë vetëm me shqyrtimin e mundësive të ndryshimit të Aktgjykimit të kundërshtuar sipas nenit 426, par. 1 të KPPK-së, Gjykata Supreme në lëndën në fjalë i nënshtrohet parimit *reformatio in pejus* për shkak të faktit se Prokurori nuk ka ushtruar ankesë ndaj Aktgjykimit të shkallës së parë. Për këtë arsye, gjetjet e Gjykatës Supreme mund të kenë vetëm karakter deklarativ.

Përderisa neni 161, par. 1 i KPK-së parasheh që vepra penale e kanosjes ekziston kur kryerësi "seriozisht e kanos personin tjetër se do ta dëmtojë me qëllim të frikësimit ose të shkaktimit të ankthit te personi i tillë", neni 267, par. 1 i KPK-së parasheh që vepra penale e detyrimit ekziston kur kryerësi "përdor forcën apo kërcënimin e rëndë për ta detyruar personin tjetër që të veprojë apo të mos veprojë në dëm të pasurisë së vet a të pasurisë së personit tjetër". Edhe pse në lëndën në fjalë, nuk është gjetur asnjë dëshmi për çfarëdo lloji të forcës së drejtpërdrejtë, Gjykata e Qarkut ka konstatuar lidhur me Pikën 1 të Aktakuzës – mbi kryerjen e veprës penale të detyrimit se "në data të ndryshme, më ose rreth datës 26 qershor 2006 dhe 1 gusht 2006, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm material" të pandehurit duke vepruar në bashkëveprim si pjesë e një grupi (duke u bazuar në një plan të përbashkët) kanë "kanosur seriozisht personin tjetër me qëllim të detyrimit për të vepruar apo mos vepruar në dëm të pasurisë së vet". Në veçanti, të pandehurit përmes përdorimit direkt të kërcënimeve me vdekje "kanë kërcënuar se do t'i vrasin palët e dëmtuara po qe se nuk tërhiqeshin nga tenderi i tyre i fituar nga AKP-ja".

Për këtë arsye është e qartë se të katër të pandehurit Xh [REDACTED] ZH [REDACTED] A [REDACTED] K [REDACTED] B [REDACTED] H [REDACTED] dhe N [REDACTED] C [REDACTED] janë shpallur fajtorë për kanosjen e palëve të dëmtuara qoftë drejtpërdrejt apo jo. Sa u përket të pandehurve B [REDACTED] H [REDACTED] dhe N [REDACTED] C [REDACTED] Aktgjykimi i kundërshtuar në pjesën e arsyetimit thekson se "nuk ka prova që B [REDACTED] H [REDACTED] dhe N [REDACTED] C [REDACTED] kanë kanosur drejtpërdrejt Sh [REDACTED] L [REDACTED] apo partnerët e tij. B [REDACTED] dhe N [REDACTED] kanë qenë investitorë me A [REDACTED] dhe kanë qenë të pranishëm kur A [REDACTED] e kishte detyruar nën kanosje Sh [REDACTED] (faqe 14 e aktgjykimit në gjuhën angleze). Kjo pasqyrohet edhe në dispozitiv, i cili përcakton se "rreth datës 8 gusht 2006, B [REDACTED] H [REDACTED] dhe N [REDACTED] C [REDACTED] kanë qenë të shoqëruar nga Sh [REDACTED] L [REDACTED] në zyrat e AKP-së në Prishtinë, kur pala e dëmtuar është tërhequr nga tenderi, duke iu mundësuar përfitime të mëdha materiale për të pandehurit". Po ashtu është pretenduar në arsyetimin e aktgjykimit të kundërshtuar se B [REDACTED] H [REDACTED] asokohe ende polic i Shërbimit Policor të Kosovës, kishte të veshur uniformën policore dhe mbante armë, së

paku gjatë një takimi me palët e dëmtuara më 28 korrik 2006 (faqe 11 e aktgjykimit të kundërshtuar në gjuhën angleze), duke krijuar në mënyrë automatike një presion mbi palët e dëmtuara.

Gjykata Supreme e ka të qartë se kushtet e kanosjes në të dy dispozitat e KPK-së kanë përmbajtje të ngjashme. Për këtë arsye, dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar përmban një kundërshti kur shpall të katër të pandehurit të pafajshëm për veprën penale të Kanosjes sipas nenit 161 të KPK-së. Megjithëkëtë, në arsyetimin e aktgjykimit zbulohet se "veprimet e të pandehurve hyjnë pikërisht brenda kufijve të sjelljes që njihet si Detyrim" dhe se "pohimet në Pikën 2 [të Aktakuzës, e cila është vepër penale e Kanosjes sipas nenit 161 të KPK-së] janë tërësisht të përfshira në veprën e detyrimit".

Edhe pse dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë i formuluar në mënyrë të ngathtë shpall të katër të pandehurit "të pafajshëm për kryerjen e veprës penale të Kanosjes në kundërshtim me nenin 161, par. 4 të KPK-së, siç qëndron në pikën 2 të Aktakuzës" ndërsa pjesa përkatëse e arsyetimit përcakton se pika 2 e aktakuzës "hedhet poshtë" (faqe 14 e aktgjykimit të kundërshtuar në gjuhën angleze), është përtej çdo dyshimi se edhe gjykata e shkallës së dytë ka qenë e mendimit se kushtet dhe përmbajtja penale e Kanosjes sipas nenit 161, par. 4 të KPK-së konsumohet nga vepra penale e Detyrimit sipas nenit 267, par. 1 dhe 2 të KPK-së.

Duke pasur parasysh faktin se Gjykata e Qarkut ka konstatuar të gjitha faktet relevante lidhur me dy veprat penale në fjalë, kundërshtia e përvijuar do të shtynte Gjykatën Supreme të Kosovës në ndryshimin e dispozitivit sipas nenit 420, par. 1, pikës 4, lidhur me nenin 426, par. 1 të KPPK-së në atë mënyrë që të katër të pandehurit do të shpallehin fajtorë edhe për kryerjen e kanosjes sipas nenit 161, par. 4 të KPK-së, gjë e cila konsumohet nga shpallja fajtorë e të pandehurve për detyrim sipas nenit 267, par. 1 dhe 2 të KPK-së. Edhe pse një skenar i këtillë nuk shpie në një dënim më të lartë për të pandehurit, fajësia shtesë e shpallur ndryshe nga aktgjykimi i kundërshtuar i shkallës së parë do të përbënte edhe një barrë penale shtesë për të katër të pandehurit në fjalë. Pasi që Prokurori nuk kishte bërë ankesë ndaj aktgjykimit të kundërshtuar, situata në rastin në fjalë bie në kuadër të parimit *reformatio in pejus* siç përcaktohet edhe me nenin 417 të KPK-së. Për këtë arsye, Gjykata Supreme në rastin në fjalë është e penguar që të ndryshojë dispozitivin në dëm të pandehurve, që edhe është arsyeja pse konstatimet përkatëse të Gjykatës Supreme kanë vetëm karakter deklarativ. Sidoqoftë, duhet të theksojmë se edhe pse çështja në fjalë është kundërshtuar vetëm nga mbrojtja e Xh. ZH. të gjithë të pandehurit tjerë duhet të gëzojnë të njëjtën mbrojtje në bazë të nenit 419 të KPK-së.

II. SHKELJA E POHUAR E NENIT 403, PAR. 2 TË KPPK-SË NGA MOS-LLOGARITJA E PARABURGIMIT:

Lidhur me kundërshtimin e mbrojtësit të Xh. ZH., se në dënim nuk është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim, Gjykata Supreme konstaton se ankesa në këtë pikë është e bazuar. Llogaritja e kohës së kaluar në paraburgim është obligim i

gjykatës sipas nenit 391, par. 1, pikës 5 të KPPK-së dhe sipas nenit 73, par. 1 të KPK-së, por në rastin në fjalë nuk është marrë parasysh, që sjell shkeljen e nenit 403, par. 2 të KPK-së.

Megjithatë, kjo shkelje nuk shkakton edhe anulimin e aktgjykimit të kundërshtuar dhe kthimin e lëndës në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë. Ky dështim i gjykatës së shkallës së parë mund të kompensohet me ndryshimin e aktgjykimit të kundërshtuar nga ana e kolegjit të Gjykatës Supreme, në pajtim me nenin 420, par. 1, pikën 4 të KPPK-së.

III. PËRSHKRIMI I KUSHTEVE LIDHUR ME VEPRIMET FAJËSUESE TË VEPRËS PENALE NË DISPOZITIV

Lidhur me pohimet e mbrojtjes së B. H. se aktgjykimi i kundërshtuar nuk ka përshkrim të qartë të veprimeve konkrete fajësuese të veprës penale lidhur me klientin e tij, Gjykata Supreme konstaton se dispozitivi i përmbush të gjitha kushtet ligjore të përcaktuara me nenin 396, par. 3 dhe 4, lidhur me nenin 391 të KPPK-së, sidomos neni 391, par. 1, pika 1 e KPPK-së përcakton që dispozitivi duhet të përmbajë *“veprimin për të cilin [të akuzuarin] e shpall fajtor së bashku me faktet dhe rrethanat që tregojnë natyrën penale të veprës penale si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitës përkatëse të Kodit Penal”*.

Këtu përmendet dispozitivi lidhur me pikën 1 të aktakuzës, me të cilin Besnik HASANI shpallet fajtor për detyrim si bashkëkryerës dhe pjesëtar i grupit së bashku me tre të pandehurit e tjerë. Dispozitivi në mënyrë të qartë thekson se të pandehurit *“kanë bërë kërcënime të rënda”* dhe *“në mënyrë specifike... kanë kërcënuar me vrasje palët e dëmtuara nëse të njëjtit nuk tërhiqen nga tenderi fitues i AKM-së (vala e 16-të) për fermën prej 32 hektarësh të deleve në fshatin R. komuna e F. Përgjatë një periudhe prej disa ditësh duke filluar rreth datës 27 korrik e deri më 1 gusht 2006, i pandehuri i ka detyruar palët fituese që të tërhiqen...”* Lidhur me aktivitetet e B. H., i cili gjithashtu sipas gjetjeve të Gjykatës së Qarkut kurrë nuk ka përmendur asnjë kanosje të drejtpërdrejtë ndaj palëve të dëmtuara, dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar e qartëson se si rezultat i këtyre kërcënimeve *“[më] ose rreth 8 gushtit të vitit 2006, B. H. dhe N. C. të shoqëruar nga Sh. L. kanë qenë të zyrat e AKM-së në Prishtinë, kur pala e dëmtuar ka dorëzuar formularin mbi tërheqjen nga tenderi ...”*.

Për arsyet e përmendura më lart, Gjykata Supreme konstaton se dispozitivi është mjaft i qartë dhe në përputhje me kushtet e përcaktuara me ligj. Nuk ka nevojë që dispozitivi paraprakisht të përsërisë të gjitha detajet të cilat më vonë theksohen në arsyetimin e aktgjykimit.

IV. PËRGJEGJËSIA PENALE E TË PANDEHURIT N. C. THJESHT SI PJESËTAR “PASIV” I GRUPIT:

Lidhur me pohimet e mbrojtësit N [REDACTED] C [REDACTED] se i pandehuri kishte vetëm një rol pasiv në të gjitha takimet, duke mos përmendur asnjë kërcënim as shoqërim të viktimës Sh [REDACTED] L [REDACTED] më vonë në zyrat e AKM-së në Prishtinë, për tërheqje nga tenderi fitues por se i pandehuri përkundër kësaj është konstatuar të ketë pasur përgjegjësi penale së bashku me të tjerët, përmendet dispozitivi i aktgjyqimit të kundërshtuar. Aty thuhet qartë se N [REDACTED] C [REDACTED] së bashku me A [REDACTED] K [REDACTED] me Xh [REDACTED] XH [REDACTED] dhe me B [REDACTED] H [REDACTED] ka vepruar në bashkëkryerje dhe në bazë të një plani të përbashkët dhe se të gjithë të pandehurit i takonin grupit kriminal. Një gjë e tillë pasqyrohet edhe në arsyetimin e aktgjyqimit (në veçanti në faqen 9 dhe 10 të aktgjyqimit të kundërshtuar në gjuhën angleze). Për këtë arsye, Gjykata Supreme konstaton se dispozitivi nuk është në kundërshtim me përmbajtjen e vet dhe nuk bie në kundërshtim as me arsyetimin e aktgjyqimit.

V. PËRGJEGJËSIA PENALE E TË PANDEHURIT A [REDACTED] K [REDACTED] SIPAS MBROJTJES SË TIJ:

Sipas mbrojtësit të A [REDACTED] K [REDACTED], kundërshtohet dispozitivi i aktgjyqimit të shkallës së parë si i paqartë dhe në kundërshtim me arsyetimin nën pikën (I), pasi që klienti i tij ka mohuar kryerjen e veprës penale në fjalë, duke u përmendur shqyrtimet e Gjykatës Supreme sipas pikës B të aktgjyqimit të mëposhtëm. Gjykata e Qarkut ka mbështetur gjetjet e veta si dhe opinionin e saj përmes një vlerësimi gjithëpërfshirës të të gjitha provave të pranueshme dhe në dispozicion dhe ka ardhur gjer tek përfundimi se i pandehuri A [REDACTED] K [REDACTED] edhe pse ka mohuar çfarëdo lloji të përgjegjësisë penale dhe të aktiviteteve në rastin në fjalë, i njëjti ka vepruar së bashku me të tjerët në bashkëkryerje si anëtar i grupit kriminal. Për këtë arsye, nuk është konstatuar asnjë kundërshti brenda dispozitivit ose në mes të këtij të fundit dhe arsyetimit. Përmendet po ashtu ajo çfarë është përmendur tashmë në pikën A. IV lidhur me të pandehurin N [REDACTED] C [REDACTED]

B. Vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike

Të katër avokatët mbrojtës e theksojnë edhe vërtetimin e gabueshme dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga ana e aktgjyqimit të kundërshtuar. Në veçanti, mbrojtësi i Xh [REDACTED] ZH [REDACTED] ka theksuar se aktgjyqimi i kundërshtuar në mënyrë të gabueshme kishte vënë lidhje partneriteti në mes të palëve të dëmtuara, dhe se ndryshe nga vlerësimet e Gjykatës së Qarkut oferta ishte bërë nga kompania ' [REDACTED]', pronar i së cilës kishte qenë Sh [REDACTED] L [REDACTED]. Përderisa në deklaratat e palëve të dëmtuara nuk është gjetur se të njëjtit kishin festuar ndonjëherë si "fitues të tenderit" siç pohohet nga gjykata e shkallës së parë, të gjitha takimet në mes të palëve të dëmtuara dhe të pandehurit në përjashtim të një takimi në S [REDACTED] janë zhvilluar pa praninë e të pandehurit. Lidhur me kanosjet e pretenduara, aktgjyqimi përmend fjalët e pakuptimta si "Jeta është shumë e çmueshme dhe njeriu duhet ta japë jetën vetëm për liri të atdheut dhe për asgjë tjetër". Mbrojtja e B [REDACTED] H [REDACTED], N [REDACTED] C [REDACTED] dhe A [REDACTED] K [REDACTED] nënvizon faktin se klientët e

tyre përkatës kurrë nuk e kanë kërcënuar asnjë njeri as nuk janë përfshirë në asnjë aktivitet penal.

I. PRETENDIMI PËR VËRTETIM TË GABUAR TË LIDHJEVE NË MES TË PALËVE TË DËMTUARA DHE FAKTEVE TË TJERA NË LIDHJE ME VIKTIMAT:

Në lidhje me pretendimet e avokatit mbrojtës të Xh. ZH. se vlerësimi i Gjykatës së Qarkut mbi marrëdhëniet e partneritetin në mes të palëve të dëmtuara Sh. L. Xh. S. dhe A. S. janë të rreme dhe se në fakt oferta në fjalë është bërë nga kompani ' ' me pronar Sh. L. Gjykata Supreme konstaton se këto detaje nuk janë me rëndësi për lëndën në fjalë dhe akuzat e sjella kundër të pandehurve. E njëjta vlen për çështjen, nëse palët e dëmtuara kanë festuar ndonjëherë të qenit 'fitues të tenderit' sikurse është vërtetuar nga Gjykata e Qarkut.

Për më tepër, mbrojtja e Xh. ZH. ka theksuar se i pandehuri i cili ishte i pranishëm gjatë një takimi, me atë rast ka përmendur vetëm disa 'fjalë të pakuptimta' sikurse 'Jeta është shumë e vlefshme dhe duhet të jepet vetëm për lirinë e vendit, për asgjë tjetër', që nuk mund të interpretohet aspak si kërcënim ndaj palëve të dëmtuara.

Në lidhje me këtë referimi është bërë në vlerësimin e provave nga Gjykata e Qarkut sikurse në veçanti gjendet nga f. 10 deri 12 të aktgjyqimit të kundërshtuar (të versionit të tij në gjuhën angleze). Gjykata Supreme konstaton se Gjykata e Qarkut – megjithëse arsyetimi i aktgjyqimit është mjaft i shkurtër – ka bërë një vlerësim të plotë dhe të kujdesshëm të gjitha provave të pranueshme dhe në dispozicion sikurse janë renditur më lart në këtë aktgjykim. Duke u bazuar në këtë vlerësim të provave, Gjykata e Qarkut në veçanti, ka vërtetuar se gjatë takimit në restorantin 'N.' më 27 korrik 2006 i pandehuri Xh. ZH. ka thënë palëve të dëmtuara Sh. L. Xh. S. dhe A. S. se "nuk mund ta merrni këtë tender, përndryshe do të hapen varre" (f.10 e aktgjyqimit të kundërshtuar në versionin e tij në gjuhën angleze). Fjalët e Xh. ZH. sikurse janë përmendur më 01 apo 02 gusht 2006 gjatë takimit me palët e dëmtuara në Sh. mbi vlerën e jetës siç është adresuar nga mbrojtja në kontekstin e dhënë, duhet të interpretohen në kuadër të qasjes së mëhershme të pandehurit si edhe mbi prapavijën e të gjitha kërcënimeve të tjera të drejtuara kundër palëve të dëmtuara gjatë periudhës kohore të referuar dhe të përmendur nga anëtarët e tjerë të grupit të cilët i kanë takuar të katër të pandehurit.

Një referim i plotë është bërë në vlerësimin e Gjykatës së Qarkut. Për më tepër Gjykata Supreme e Kosovës shumë herë ka vendosur se nuk është as në kompetencë të kolegjit ankimor e, në fakt, as nuk është e mundshme që të zëvendësohen gjetjet e gjykatës së shkallës së parë me të vetat, posaçërisht pa i marrë të gjitha provat përsëri. Në lidhje me këtë, në lëndën *Runjeva, Axgami dhe Dema (Gjykata Supreme e Kosovës, AP-KZ 477/05 të datës 25 janar 2008, faqe 20)*, si edhe – në mes tjerash – në lëndën kundër *Jeton Kiqina (Gjykata Supreme e Kosovës, P.nr. 84/2009 të datës 03 dhjetor 2009)* Gjykata Supreme e Kosovës në këtë kontekst ka vënë në pah se "procedura ankimore në KPPK

mbështetet në parimet që trupi gjykues i dëgjon, vlerëson dhe peshon provat në gjykim [...]. Prandaj, gjykata e apelit duhet t'i jap trupit gjykues hapësirë veprimi për gjetjet e saj faktike. Nuk duhet t'i trazoj gjetjet e trupit gjykues për t'i zëvendësuar me të vetat, përveç nëse provat në të cilat është mbështetur trupi gjykues nuk do të ishin pranuar nga asnjë gjykatë e arsyeshme e faktorit ku vlerësimi i saj ka qenë 'tërësisht i gabuar'.

II. RËNDËSIA E MOHIMIT TË AKTIVITETEVE PENALE NGA TË PANDHEURIT B [REDAKTUAR] H [REDAKTUAR] N [REDAKTUAR] C [REDAKTUAR] DHE A [REDAKTUAR] K [REDAKTUAR]

Në lidhje me avokatët mbrojtës të B [REDAKTUAR] H [REDAKTUAR] N [REDAKTUAR] C [REDAKTUAR] dhe A [REDAKTUAR] K [REDAKTUAR] të cilët theksojnë se klientët e tyre përkatës nuk e kanë kërcënuar asnjëherë askënd e as nuk janë përfshirë në ndonjë veprimtari penale, një referim i plotë i është bërë përsëri vlerësimit të provave të kryer nga Gjykata e Qarkut. Pasi që gjykata e shkallës së parë e ka bazuar mendimin e saj në atë çfarë ka ndodhur në një vlerësim të plotë të provave sikurse është vënë në pah më parë, nuk mund të thuhet se vlerësimet e saj kanë qenë 'tërësisht të gabuara' e që është ajo pse Gjykata Supreme nuk ka arsye për të zëvendësuar vlerësimin e Gjykatës së Qarkut.

C. Shkelja substanciale e Ligjit Penal

Të katër avokatët mbrojtës pohojnë se si pasojë e vërtetimit të pretenduar të gabuar dhe jo të plotë të fakteve është shkelur edhe ligji penale në lidhje me gjetjet e shpalljes fajtor të të mbrojturve të tyre përkatës. Në veçanti mbrojtja e Xh [REDAKTUAR] XH [REDAKTUAR] thekson se Neni 404 paragrafi 1 i KPPK do të shkelej për shkak të faktit se koha e kaluar në paraburgim e klientit të tij nuk është cilësuar. Edhe mbrojtja e N [REDAKTUAR] C [REDAKTUAR] edhe e A [REDAKTUAR] K [REDAKTUAR] kundërshtojnë aktgjykimin me të cilin të mbrojturit tyre janë shpallur fajtor për Detyrim megjithëse nuk janë vërtetuar as kërcënimet e as shkeljet sikurse kërkohet me ligj.

Gjykata Supreme konstaton se këto pretendime të mbrojtjes janë pa meritë dhe të pabazuara, në veçanti pasi që ato aspak nuk janë provuar. Referimi i është bërë në atë çfarë është thënë nën pikat A. dhe B. të aktgjykimit. Rrjedhimisht, nuk është parë e nevojshme që më tej të shtjellohet për pretendimet e mbrojtjes në kontekstin e dhënë.

D. Vendimi mbi dënimin

Si pasojë e mëtejme, të gjithë avokatët mbrojtës janë të mendimit se dënimi i shqiptuar ndaj të mbrojturve të tyre përkatës, është shumë i lartë. Në veçanti mbrojtja e Xh [REDAKTUAR] ZH [REDAKTUAR] dhe N [REDAKTUAR] C [REDAKTUAR] kanë theksuar se të mbrojturit e tyre janë tërësisht të pafajshëm dhe prandaj duhet të lirohen, përderisa avokatët mbrojtës të të pandehurve B [REDAKTUAR] H [REDAKTUAR] dhe A [REDAKTUAR] K [REDAKTUAR] propozojnë që së paku të shqiptohet një dënim më i butë ndaj të mbrojturve të tyre.

Vendimi mbi dënimin është më tepër sesa i drejtë për kohëzgjatjen e burgimit të shqiptuar ndaj secilit të pandehur.

Gjykata e shkallës së parë në pajtim me kornizën e dënimeve të mundshme të dhëna nga ligjet relevante, ka shqiptuar për veprën penale të Detyrimit në pajtim me nenin 267 paragrafët 1 dhe 2 të KPK-së dënim të veçantë prej tri vite burgim për secilin A [REDAKTUAR] K [REDAKTUAR] dhe Xh [REDAKTUAR] ZH [REDAKTUAR] dhe të një viti dhe dy muaj për secilin B [REDAKTUAR] H [REDAKTUAR] dhe N [REDAKTUAR] C [REDAKTUAR], përderisa maksimumi i burgimit i lejuar nga ligji është në mes të një deri në 10 vite.

Për veprën penale të Mbajtjes në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve në pajtim me nenin 328, paragrafit 2 të KPK-së, Gjykata e Qarkut ka shqiptuar dënimin prej 1500 Eurove për secilin prej të pandehurve Xh [REDAKTUAR] ZH [REDAKTUAR] dhe A [REDAKTUAR] K [REDAKTUAR], përderisa ligji lejon dënimin e gjobës deri në 7,500 Euro apo të burgimit prej një deri në tetë vite.

Gjykata Supreme e Kosovës konsideron që Gjykata e Shkallës së Parë në mënyrë të saktë dhe të plotë ka marrë parasysh të gjithat rrethanat që ndikojnë në ashpërsinë e dënimit dhe në mënyrë të drejtë ka vlerësuar këto rrethana.

Megjithatë, duket pothuajse vajtueshëm që PShRK-ja nuk është ankuar në aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut, së paku lidhur me veprën penale të Mbajtjes në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve në pajtim me nenin 328 paragrafit 2 të KPK-së e kryer nga të pandehurit A [REDAKTUAR] K [REDAKTUAR] dhe Xh [REDAKTUAR] ZH [REDAKTUAR]. Të dytë kanë poseduar në mënyrë ilegale arsenal të tërë të armëve të rënda të luftës, të mjaftueshme për të pajisur një armatë private, por janë dënuar me 1.500 Euro secili prej tyre, përderisa *status quo ante* në Kosovë sa i përket kësaj është burgimi prej së paku një viti, bile në lëndët më pak të rënda. Megjithatë, për shkak të faktit që PShRK-ja nuk është ankuar, Gjykata Supreme është e lidhur me parimin e *reformatio in pejus* dhe kështu është parandaluar për rritjen e dënimit lidhur me këtë.

Së paku asnjë arsye nuk shihet për të ulur dënimin kundër ndonjërit prej të pandehurve. Gjithashtu duke marrë parasysh intensitetin e kërcënimeve të shprehura kundër palëve të dëmtuara e gjithashtu edhe nivelit të rrezikut shoqëror të kryerjes së veprave përkatëse penale dhe nivelit të përgjegjësisë së të pandehurve, të fundit janë dërguar me rregull me dënimin e shqiptuar unik. Duhet të theksohet që sjellja e treguar nga të pandehurit në lëndën në fjalë është një nga pengesat kryesore për shoqërinë kosovare për të gjetur mënyrën e tyre në jetën e qëndrueshme dhe të besueshme, kështu në jetën shoqërore të qetë dhe të sjelljes së drejtë, të përshtatshme për zhvillimin e ekonomisë së qëndrueshme si garanci për jetë të pasur dhe të mirë për shumicën e popullatës së Kosovës.

A. Konfiskimi i Armëve

Armët pasi që janë poseduar ilegalisht nga të pandehurit Xh [REDAKTUAR] ZH [REDAKTUAR] dhe A [REDAKTUAR] K [REDAKTUAR] është dashur të konfiskohen sipas detyrës zyrtare *ex officio* në pajtim me nenin 328, paragrafin 5 e lidhur me nenin 54, paragrafin 2 dhe nenin 60, paragrafët 2 dhe 3 të KPK-së. Pasi që konfiskimi i armëve të poseduara në mënyrë ilegale të cilat janë

përdorur ose kanë mund të përdoren për kryerjen e veprave penale është e obligueshme sipas ligjit, vendimi përkatës i Gjykatës Supreme nuk e shkel parimin e *reformatio in pejus*, - Neni 417 i KPPK-së vetëm e kufizon ndryshimin në dëm të akuzuarit me respekt në klasifikimin e veprës penale dhe të sanksioneve të shqiptuara penale përderisa masa e konfiskimit i takon cilësdo prej këtyre dy kategorive. Konfiskimi është i në mënyrë të obliguar i urdhëruar sipas nenit 328, paragrafit 5 të KPPK-së dhe i shërben mbrojtjes së shoqërisë. Si pasojë ka përparësi ndaj të drejtës së kryerësit në posedim ose pronë.

Për arsye të lartpërmendura, Gjykata Supreme ka vendosur si në dispozitiv.

Anëtare e kolegjit

Anne Kerber
Gjyqtare e EULEX-it

Anëtare e kolegjit

Marije Ademi
Gjyqtare e Gjykatës Supreme

Kryetar i kolegjit

Gerrit-Marc Sprenger
Gjyqtar i EULEX-it

Procesmbajtës

Holger Engelmann
Zyrtar ligjor i EULEX-it

Gjykata Supreme e Kosovës
AP.-KŽ. nr. 62/2012
Prishtinë
8 maj 2012